

## SHFMU “SELAMI HALLAQI” – GJILAN

### RAPORTI PËR PILOT PROJEKTIN “ME MË SHUMË MËSUES PËR KLASAT 3,4 DHE 5”

Nga takimet që drejtoria e shkollës ka organizuar me akterët e përfshirë në implementimin e këtij pilot-projekti si: Profesor të fakultetit të edukimit, përfaqësues të DKA, drejtor shkollash, këshillin e shkollës, këshillin e prindërve të shkollës, këshillin e nxënësve, me mësimdhënës si dhe me GIZ Gjerman jemi dakorduar që shkolla jonë të filloj së implementuari me pilot projektin “ Me më shumë mësues për klasat 3,4 dhe 5”.

Pas përgatitjeve të bëra me kohë si, ndarja e orëve dhe përpilimi I orarit mësimor, arsimtarët po punojnë intenzivisht dhe me shumë përgjegjësi me nxënës.

Nga takimet që I kam zhvilluar me aktivitet e klasëve 3,4 dhe 5 si dhe me prindërit e të gjitha klasëve (18 klasë) I kemi nxjerrë këto përparësi, vështirësi dhe mundësi:

Përparësitë	Vështirësitë	Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"><li>- Pilot projekti është pranuar nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit</li><li>- Më pakë përgatitje me shkrim nga mësimdhënësit</li><li>- Më shumë punë në përgatitje të lëndëve të përzgjedhura( përgatitje profesionale)</li><li>- Vlerësimi I nxënësve do të jetë I vazhdueshëm dhe real</li><li>- Bashkëpunimi në mes arsimtarëve në aktive është shtuar</li><li>- Po respektohet orari mësimor</li><li>- Kan dalur në pah nxënësit problematik dhe po punohet me ta</li><li>- Orët e shkathtësive po mbahen me shumë përkushtim</li><li>- Atraktivitet gjatë orëve të mësimit tek nxënësit</li><li>- Janë aktivizuar prindërit</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Lodhje më e madhe tek mësimdhënësit</li><li>- Probleme në adaptim nga nxënësit me shumë kriterie e forma të punës</li><li>- Notimi real I ndryshëm nga ai më parë dhe vështirësi të binden prindërit me suksesin aktual</li><li>- Është shtuar volumi I punës edhe për prindërit dhe përgjegjësi ma e madhe për ta</li><li>- Ka më shumë përgjegjësi e llogaridhënie</li><li>- Komunikimi me prindërit e klasëve ku jepin mësim</li><li>- Mungesa e mjeteve të konkretizimit</li><li>- Vështirë po e pranojnë përgjegjësinë disa mësimdhënës</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Të shtohet bashkëpunimi Arsimtar-prind-nxënës</li><li>- Të shtohet edhe më shumë bashkëpunimi në fusha dhe në aktive</li><li>- Bartja e problemit me nxënës tek pedagogja dhe drejtoria</li><li>- Të bëhet vlerësimi sistematik dhe me kohë</li><li>- Të njoftohen prindërit me kohë për të arriturat dhe ngecjet për fëmijët e tyre</li><li>- Mentorimi kolegjal në kontest të ngritjes së cilësisë</li><li>- Shfrytëzimi I sallës së edukates fizike dhe kabinetit të muzikës</li><li>- Trajnimet e vazhdueshme për mësimdhënësit sipas kërkësave dhe nevojave</li><li>- Matja e arritjeve të nxënësve permes ndonjë testi periodik të organizuar nga shkolla</li></ul>

<p>më shumë në ngritjen e cilësisë duke bashkëpunuar me nxënës dhe mësimdhënës</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Janë shpërfaqë tri lloje të mësimdhënësve: Ata që janë shumë të mirë dhe të përgjegjshmëm, ata mesatarisht të përgjegjshëm dhe ata më pakë të përgjegjshëm.</li> <li>- Futja e konkurencës në punë tek mësimdhënësit</li> </ul>		<p>apo akterët e jashtëm</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hulumtime periodike për opinionet e akterëve të përfshirë në projekt permes pyetsorëve</li> <li>- Të përcillët puna e mësimdhënësve çdo muaj dhe në se cilën lëndë e klasë</li> <li>- Të motivohen mësimdhënësit për punën që po e bëjnë</li> </ul>
---	--	---

Nga analiza e mësipërme konstatojmë se pilot projekti ka filluar mirë dhe po vazhdon me mjaft përkushtim e me rezultate implementimi I tij.

Te nxënësit po vërehet një atmosferë e re pune, te prindërit një motivim dhe dëshirë për suksesin e fëmijëve të tyre, te mësimdhënësit një angazhim më I madhë dhe një përgjegjësi e re.

Poashtu edhe për stafin e shkollës një sfidë e re, një angazhim I shtuar dhe përgjegjësi të reja.

Në përgjithësi projekti po ecën shumë mirë.

**Kërkesë:** Të realizohën premtimet e dhëna nga univerziteti Kadri Zeka, nga stafi I saj, nga akterët tjere e poashtu një përkrahje e premtuar edhe nga GIZ në mbështetje logjistike.

**Falënderim:** Falënderojmë GIZ-in për realizimin e trajnimit të mësimdhënësve të shkollës sonë të përfshirë në projekt si dhe kompletimi I një klase me mjete dhe inventar të nevojshëm për nevoja të shkollës e sidomos për punëtori apo trajnime.

#### Sygjerim:

- Ky pilot projekt me modifikime të bëhet projekt I Ministrisë së Arsimit dhe të implementohet në tërë Kosovën.
- Të organizohën trajnime enkas për lëndët profesionale nga ekspertët e lëndëve.
- Të shqyrtohet mundësia e angazhimit të mësimdhënësve të lëndëve profesionale dhe të jepin mësim në ciklin fillor duke e zvogluar normën në 20 orë mësimi në javë për mësimdhënësit e arsimit fillor.
- Fakulteti I edukimit të përgatis kuadro në të ardhmën sipas fushave kurrikulare

Më, 15.11.2018

Drejtori

Gjilan

Florim Maloku